



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 10.11.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 3,061,841 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE.

Baza ligjore:

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit: "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme"-kodi i produktit 91707AB

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 3,061,841 (tremilion e gjashtëdhjetë e njëmijë e tetërqind e dyzetë e një) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemer	Njësia Administrative	Data e kërkesës	Shkaku i fatkeqesise sipas -- VKM-së 329, datë 16.5.2012- ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"	Preventivi per orendit/s endet llogaritur nga KQD	Preventivi per materiale ndertimi llogaritur nga KQD, ne masen 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012,	Vlera e dëmit totale perfitues
1	Sabri Murrizi	Nr.4	19.04.2024	Zjarri	694,000	-	694,000
2	Brunilda Bektashi	Nr.3	06.09.2024	Zjarri	547,000	147,834	694,834
3	Ibrahim Jaupaj	Nr.4	07.01.2025	Zjarri	513,000	21,794	534,794
4	Lavdrim Kica	Sukth	04.04.2025	Zjarri	148,549	131,831	280,380
5	Ervis Mehmeti	Nr.6	07.04.2025	Zjarri	280,454	73,475	353,929
6	Dashamir Boshnjaku	Katund i Ri	28.05.2025	Zjarri	356,666	147,238	503,904
Total							3,061,841

2. Ky fond do të merret nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile, i akorduar me kodin e produktit: 91707AB, "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transfertat etj):

Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

Drejtorja/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtorja e Shërbimeve Publike.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Njesisë Administrative Nr. 3, 4, 6, Sukth dhe Katund i Ri, Bashkia Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 10.11.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 6 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari hapë mbledhjen me pikë 6 të renditjes
dites, pyeti nese ka pyetje: jo.

Të gjithë anëtarët prezantuan ishin dakord për miratimin.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar

Rolant Xhelilaj

PRO [Signature]

Zv/Kryetar

Erzen Laçi

Sekretar

Hekuran Markola

PRO [Signature]

Anëtar

Jonada Mamo

PRO [Signature]

Anëtar

Alfred Mullaraj

PRO [Signature]

Anëtar

Denisa Luarasi

PRO [Signature]

Anëtar

Silvana Agasi

PRO [Signature]

Anëtar

Dritan Burgija

Anëtar

Jonuz Myshketa

Anëtar

Xhojana Gjineci

Anëtar

Kontjana Kuçi

Pro [Signature]